

Nr.regj.14815/12

GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË,me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur sipas Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundervajtje me nr;1094/2012,të dt.22.10.2012, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Naser Fadil Osmanit, për kundërvajtje nga neni 5.dhe 6.parg.1 dhe 3,si dhe neni 9 e sanksionua me nenin 17 parg.1 pika 3. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, me nr.04/L-050, e në bazë të neni 73,74,195, dhe 199 si dhe neni 10 të Ligjit mbi kundervajtjet, me dt.**01.02.2013** merrë këtë,

A K T V E N D I M

I PANDEHURI:Naser Fadil Osmani i lindur me 04.05.1962,fsh."Magure"K.Lipianit,ku edhe tani jetonë,i martuar,babë e 3 femijve, e gjendjes së mesme ekonomike,fakultetin ekonomik të kryer,Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse si Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit për vitin 2011,në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohtuar me kohë përë këtë obligim ligjor,i njeiti është vonuar deri me datën 11.04.2012,ku edhe e ka bërë deklarimin e pasurisë.

Me veprim të këtill ka kryer kundervajtje nga neni 5.dhe 6 paragrafi 1dhe.3 si dhe neni 9 e sanksionuar me nenin 17parg.1 pika 3 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë i shqiptohet:

Q O R T I M

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur,

Konform neni 109.6 në emer të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 15 EURO, në afat prej 15 eurosh në arken e gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-1623/12 të parashtruar gjykatës me datën 02.05.2012 për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendur me lartë, për kundervajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata komunale për kundervajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kërkesës,e zhvilloj procedurën kundërvajtse dhe të pandehurin e shpalli fajtor,i shqiptoj denimin Qortim,si dhe e obligoj që në emer të paushallit gjyqësor ta paguaj shumën prej 15 eurosh.

Parashtruesi i kërkesës Agjencioni Kundër Korrupsionit në aftain e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundervajtje në Prishtinë,me arsyetim së të pandehurit nuk ju ka shqiptue masa adekuate e denimit,por siq thuhet në ankesë ju ka shqiptue denimi i butë.

Gjykata e Lartë për Kundervajtje me dt.22.10.2012,me Aktvendimin me nr:1094/12,date 22.10.2012 e Abrogon Aktvendimin me nr.Regj:14815/12,lënden ja kthenë Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ku e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin se a e ka dorzue i pandehuri formularin gupit parlamentar apo administrates së Kuvendit.

Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJL.NR.1094/2012,me dt.22.10.2012,gjyqtari thirri në cilësin e deshmitarit parshtruesin e kërkesës përfaqësuesin e Agjencionit Kunder Korrupsionit në Prishtinë,Agron Bajramin,dhe të pandehurin Naser Osmanin.

Përfaqësuesi i Agjencionit Kunder Korrupsionit Agron Bajrami në deklaratën e tij thekson:Se është e vertet se Naser Osmani e ka bërë deklarimin e pasurisë me datën 11.04.2012,si dhe është e vertet se i ka derguar një mesazh Drejtorit dhe e ka njohtuar se do të vonohet sepse i njeiti nuk kishte qenë në Kosovë.

Në deklaratën e tij i pandehuri Naser Osmani deklaroi se nuk është e vertet se unë nuk e kam deklarue pasurinë për vitin 2011,nga se unë e kam plotësue formularin mbi ndryshimet e pasurisë,dhe në mesazh e

2.

kam lajmruar Drejtorin e Agjencionit Hasn Preteni se unë ditën e fundit e kam deklaruar pasurinë dhe e kam dorzuar të grupi parlamentar.

Gjykatësi edhe një herë shqyrtoj deklaratën e të pandehurit të dhenë para kësaj gjykate me datën 20.09.2012, me kujdes shqyrtoj edhe një herë deklaratën e parashtruesit të kërkesës, si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe erdhi në përfundim se i pandehuri Naser Osmani e ka kryer kundërvajtjen e cila i ngarkohet, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë, sepse sipas vertetimit të lëshuar nga Agjencioni Kunder Korrupsionit shifet se i pandehuri e ka deklaruar pasurinë me datën 11.04.2012, për çka është vonuar 11 ditë.

Me rastin e caktimit të denimit-Qortim- gjyqtari konform nenit 7 të LMK-së vlersoj rrethanat nën të cilat është krye kundërvajtja, duke i analizuar rrethanat rënduese dhe rrethanat lehtësuese.

Si rrethana lehtësuese gjyqtari mori parasysh se i pandehuri nuk ka pas qëllimin që mos ta bëjë deklaratimin e pasurisë, se e ka lajmruar drejtorin e Agjencionit se do të vonohet, se formulari i plotësuar është vonuar për tu dorzuar siq thot i pandehuri nga vozitësi i LDK-së i quajtur Blerim.

Gjykatësi i muarr parasysh të gjitha këto rrethana andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë QORTIM, do të arrihet të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmen nuk do ta kryej një kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme.

Me sa u tha më lartë u vendosën në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Apelit-Divizionit për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada

DPK/DTP
02

03-532/13
20.02.2013